



Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, raportoï pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Shqipërisë, mbi aktivitetin e institucionit dhe zhvillimet e tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së gjatë vitit 2012.

*Vijon në faqen 2*



## VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2013

*Vijon në faqen 3*

## ZHVILLIME TË TJERA

Konferenca Vjetore mbi Legjislacionin Evropian të Sigurimeve (28 shkurt-1 mars 2013)

*Vijon në faqen 3*

Takimi i Komitetit Teknik dhe seminarin e zhvilluar nga IOPS, Bukuresht, Rumani (28 shkurt-1 mars 2013)

*Vijon në faqen 4*

Mbledhje e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s (7 mars)

*Vijon në faqen 5*

Mbi takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit, BE-Shqipëri (8 mars)

*Vijon në faqen 6*

Mision ekspertize pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivat e Bashkimit Evropian për sigurimin e detyrueshëm motorik (12-13 mars)

*Vijon në faqen 6*

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në takime pune me drejtues të Bankës Kombëtare të Çekisë lidhur me pensionet private vullnetare (14-15 mars)

*Vijon në faqen 7*

Takime të Nënkomiteteve të IAIS, Bazel, Zvicër (19-22 mars)

*Vijon në faqen 8*

## LAJMET NGA RAJONI

Bosnje-Hercegovinë

*Vijon në faqen 8*

Kroaci

*Vijon në faqen 9*

Mali i Zi

*Vijon në faqen 9*

## **Kryetarja e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, raporton në Komisionin për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë mbi veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2012**

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, raportoi pranë Komisionit për Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Shqipërisë, mbi aktivitetin e institucionit dhe zhvillimet e tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së gjatë vitit 2012.

Në fjalën e saj, Znj. Shehi pasqyroi në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë e institucionit, porë si në këndvështrimin e mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve financiare nën mbikëqyrjen e AMF-së, ashtu edhe në këndvështrimin e sfidave që paraqet zhvillimi dhe forcimi i mëtejshëm institucional i AMF-së.

Në raportim u evidentuan zhvillimet në tregun e sigurimeve, treg i cili ruan peshën më të madhe ndër tregjet e mbikëqyrura dhe për rrjedhojë, merr një pjesë të konsiderueshme të burimeve të AMF-së. Volumi i primeve të shkruara bruto, gjatë vitit 2012 u rrit me afro 9% krahasuar me një vit më parë.

Tregu i letrave me vlerë, gjatë vitit 2012, pati si zhvillimin më dallues veprimtarinë e dy fondeve të investimeve, në lekë dhe në euro, të cilat arritën vlera asetesh nën menaxhim prej mbi 16 miliardë lekë brenda më pak se një viti të aktivitetit të tyre.

Edhe tregu i pensioneve private vullnetare pati rritje gjatë vitit 2012, ku totali i asetëve neto të tre fondeve të pensioneve u rrit me afro 83%.

Kryetarja e Autoritetit paraqiti edhe rolin aktiv që AMF luan në mbrojtje të interesave dhe edukimit të vazhdueshëm të konsumatorëve.

Zhvillimin institucional, forcimin e pavarësisë financiare të AMF-së, Znj. Shehi e cilësoi si mjaft të rëndësishëm dhe thelbësor në përballimin e sfidave të mëtejshme. Për këtë ajo kërkoi mbështetjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, për të shtyrë më tej procesin e miratimit të ndryshimeve të dy ligjeve tepër të rëndësishme, që AMF tashmë i ka draftuar, si ligji për AMF-në, ligji për sigurimet, si dhe një sërë ndryshimesh të tjera ligjore, që AMF do të propozojë gjatë vitit 2013.

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë e vlerësoi pozitivisht veprimtarinë e AMF-së gjatë vitit 2012. Pavarësisht një viti relativisht të vështirë, tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF kanë shfaqur tregues pozitivë dhe dinamikë të konsiderueshme, si në rritje ashtu edhe në ofrimin e produkteve të reja. Gjithashtu Komisioni vlerësoi punën e AMF-së në drejtim të rritjes së vazhdueshme të cilësisë së mbikëqyrjes dhe bashkëpunimit efektiv me institucionet brenda dhe jashtë vendit.

Informacioni i plotë për raportimin në Kuvend gjendet në faqen zyrtare të AMF-së në Internet

<http://amf.gov.al/files/File/Raportimi%20Komisioni%20te%20Ekonomise%20per%20viti%202012,%202011%20mars%202013.pdf>



*Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat, të Kuvendit të Shqipërisë*

Komisioni i Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë e vlerësoi pozitivisht veprimtarinë e AMF-së gjatë vitit 2012. Pavarësisht një viti relativisht të vështirë, tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF kanë shfaqur tregues pozitivë dhe dinamikë të konsiderueshme, si në rritje ashtu edhe në ofrimin e produkteve të reja.

## VËSHTRIM MBI TREGJET

### Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shkurt 2013

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) publikon Buletinin Statistikor për periudhën janar-shkurt 2013. Për çdo të interesuar, Buletini Statistikor përmban pasqyra të detajuara të ndarjes së tregut të sigurimeve, sipas llojit të sigurimit, produkteve të sigurimit, pjesëmarrjes së shoqërive të sigurimit në treg, etj.

Materiali i plotë i raportit statistikor (në versionin EXCEL) gjendet në <http://amf.gov.al/news.asp?id=880>

## ZHVILLIME TË TJERA

### Konferenca Vjetore mbi Legjislacionin Evropian të Sigurimeve

28 shkurt-1 mars 2013

Konferenca e Vjetore mbi Legjislacionin Evropian të Sigurimeve u mbajt në datat 28 shkurt-1 mars në Trier, Gjermani. Konferenca u organizua nga Akademia e Ligjit Evropian, (*Academy of European Law, ERA*). Qëllimi kryesor i konferencës është të informojë pjesëtarët e saj me zhvillimet e reja në fushën e legjislacionit evropian për sigurimet. Pjesëmarrës në konferencë ishin juristë që zhvillonin aktivitetin e tyre lidhur me legjislacionin në sigurime në kompanitë e sigurimeve, grupe të interesit, hartues të politikave legjislative dhe akademikë. Në dy ditët e konferencës u trajtuan temat kryesore që lidheshin me:



- Iniciativat më të fundit të Komisionit Evropian;
- Sfidat pas ngjarjeve me *Test-Achats* dhe procedurat për mbrojtjen e konsumatorit (*Test-Achats* është një organizate belge jo fitimprurëse e cila promovon mbrojtjen e konsumatorit. Ajo është themeluar në vitin 1957.);
- Aksidentet e trafikut ndërkuftar;
- Hapat për zbatimin e *Solvency II & Omnibus II*;
- Rregullat e ardhme në përmirësimin e transparencës, paralajmërimi i hershëm për risqet, aftësia paguese, zgjidhja e konflikteve dhe *IMD2, KIDs & PRIPs*.

Kjo Konferencë Vjetore synon të përmbushë kërkesat e juristëve që merren me çështjet e sigurimit për t'i mbajtur ata të informuar në lidhje me zhvillimet e fundit në vendet e BE-së.

Kjo Konferencë Vjetore synon të përmbushë kërkesat e juristëve që merren me çështjet e sigurimit për t'i mbajtur ata të informuar në lidhje me zhvillimet e fundit në vendet e BE-së.

## Takimi i Komitetit Teknik dhe seminarin e zhvilluar nga IOPS, Bukuresht, Rumani

28 shkurt-1 mars 2013

Takimi i radhës i Komitetit Teknik të IOPS-it si dhe seminari me temë “Zhvillimet në fushën e pensioneve në Rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore” u zhvillua në Bukuresht, Rumani në 28 shkurt-1 mars. Pjesëmarrësit në këto takime ishin nga vendet anëtare të IOPS-it, *Pensions Europe*, Banka Botërore, OECD si dhe nga fusha akademike, Universiteti i Varshavës, etj.



Në takimin e Komitetit Teknik të IOPS-it, çështjet kryesore që u trajtuan lidheshin me projektet e reja si “Mbikëqyrja e Shpërndarjes së *Anuiteteve*” IOPS/TC(2013)3 dhe “Mbikëqyrja e *Auto-Enrolment*” IOPS/TC(2013)4, “Praktikat të mira për qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve” IOPS/TC(2012)3/REV3, përditësim të projekteve, “Puna e IOPS-it mbi kostot dhe tarifat” IOPS/TC(2012)6/REV2 dhe “*Stress testing* në planet e pensionit” IOPS/TC(2012)5/REV3, drafte të cilat priten të miratohen në mbledhjen e radhës së IOPS-it. Gjithashtu u bënë edhe përditësime lidhur me:

- Reformat e pensioneve në Peru;
- Hedhja në treg e *auto-enrolment* (përzgjedhja nga vetë i punësuarit i fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese) nga Britania e Madhe;
- Rregullat e mbikëqyrjes së kujdesshme nga Australia;
- Reformat në pensione dhe strukturën mbikëqyrëse në të gjithë sektorin financiar në Lituani;
- Rastet e studimit mbi *toolkitet* si dhe baza e të dhënave e krijuar nga ISSA, OECD dhe IOPS për pensionet private dhe të detyrueshme.

Në seminarin mbi “Zhvillimet në fushën e pensioneve në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore” çështjet kryesore që u trajtuan lidheshin me:

- Parashikimet mbi rolin e sektorit të pensioneve publike e private, në veçanti atë në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, si u përshtat sistemi privat i pensioneve me krizën ekonomike dhe cilat ishin reagimet e politikave ndaj saj;
- Rolin e ndërmjetësve në sistemin e pensioneve dhe kontrollin e kostove. Në lidhje me këtë temë u diskutua rreth punës së IOPS-it mbi kostot dhe tarifat dhe se si tregtohen pensionet në vende të ndryshme të rajonit apo si kontrollohen kostot;
- Rolin e garancive në planet e pensionit, (sa do të kushtojë dhe si do të sigurohen garancitë shtesë për funksionimin e planeve të pensionit);

- Pikëpamjet e mbikëqyrësve dhe vetë fondeve të pensionit mbi riskun e këtyre fondeve me kontribute të përcaktuara, zgjedhjen e investimeve dhe dështimet e mundshme, çështje për të cilat u shtruan pyetje se cila është mënyra më e mirë për të krijuar dhe mbikëqyrur skemat me kontribute të përcaktuara, kush do të ishte strategjia e duhur e investimit dhe sistemet e menaxhimit të riskut aktual, cili është risku i investimit në këto skema, apo efekti i kufizimeve në investime dhe në performancën e fondit të pensionit, etj.

## Mbledhje e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s

7 mars

Nënkryetarja e AMF-së, Znj. Enkela Idrizi mori pjesë në mbledhjen e Komitetit Rajonal Evropian të IOSCO-s (*International Organization of Securities Commissions*) e cila u zhvillua në 7 mars në Lisbonë, Portugali.

Në këtë mbledhje u diskutua për risqet e mundshme në tregjet financiare evropiane dhe pasojat e mundshme në parimet udhëheqëse të drejtimin financiar. Po kështu u shkëmbyen edhe idetë e para lidhur me mundësitë e drejtimeve të reja të bashkëpunimit si për çështjet e bashkëpunimit ndërkufitar, mbrojtjen e konsumatorëve duke përfshirë edhe mbrojtjen e investitorëve, sanksionet dhe qeverisjen e korporatave. Një vëmendje e veçantë ju kushtua edhe rolit të rregullatorëve të letrave me vlerë dhe mundësisë për të ndërtuar një grup pune *ad-hoc* për të adresuar çështje që lidhen si me tregjet rajonale në Evropë apo më gjerë.

Në mbledhje u diskutua për procesin e nënshkrimit të marrëveshjeve multilaterale të bashkëpunimit prej disa organizmave anëtare të IOSCO-s si edhe tema të tjera organizative.

IOSCO është themeluar në 1983 si një organizëm ndërkombëtar që mbledh rregullatorët e tregjeve të letrave me vlerë në të gjithë botën dhe është e njohur si përcaktues i standardeve për sektorin e letrave me vlerë. IOSCO zhvillon, zbaton dhe promovon aderimin tek këto standarde duke punuar së bashku edhe me G20 dhe Bordin e Stabilitetit Financiar (*Financial Stability Board, FSB*). Ajo ka anëtarë nga 120 rregullatorë në tregjet e letrave me vlerë duke rregulluar më shumë se 95% të tregjeve botërore të tyre. AMF është anëtar i saj që prej vitit 1998.



Në këtë takim u diskutua për risqet e mundshme në tregjet financiare evropiane dhe pasojat e mundshme në parimet udhëheqëse të drejtimin financiar.

Qëllimi i këtij takimi është shqyrtimi i zhvillimeve legjislativë dhe institucionale të Shqipërisë që prej takimit të tretë të marsit të vitit 2012 të këtij Komiteti

## Mbi takimin e Komitetit të Stabilizim-Asociimit, BE-Shqipëri

8 mars

Në datën 8 mars 2013, u zhvillua në Bruksel takimi i katërt i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE Shqipëri, i cili monitoron zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.



Qëllimi i këtij takimi është shqyrtimi i zhvillimeve legjislativë dhe institucionale të Shqipërisë që prej takimit të tretë të marsit të vitit 2012 të këtij Komiteti dhe vlerësimi nga pala evropiane i progresit të bërë nga Shqipëria në përmbushjen e angazhimeve që burojnë nga dokumentet strategjike si Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, Dokumenti i Partneritetit Evropian (2007), Rekomandimet e Raportit të Progresit 2012, si dhe rekomandimet e Nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit të zhvilluara gjatë vitit 2012 dhe 2013.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadrin e këtij takimi hartoi raportin përkatës duke u fokusuar në zhvillimet që kanë pasur tregjet financiare nën mbikëqyrje në aspektin e zhvillimeve legjislativë dhe rregullatore, me qëllim përafrimin me *acquis* e BE-së, si dhe ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale gjatë vitit 2012.

## Mision ekspertize pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për përafrimin e legjislacionit shqiptar me direktivat e Bashkimit Evropian për sigurimin e detyrueshëm motorik

12-13 mars

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat e Bashkimit Evropian, ekspertë të BE-së po ndihmojnë Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare në rishikimin e ligjit për sigurimin e detyrueshëm motorik në sektorin e transportit. Misioni i ekspertizës, zhvillohet në zbatim të angazhimeve që Shqipëria ka për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Ky mision, i cili përfaqëson një program trajnimi për punonjësit e AMF-së lidhur me legjislacionin aktual evropian, u zhvillua në 12-13 mars, pranë AMF-së. Programi mbështetet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet instrumentit TAIEX (Technical Assistance and Information Exchange).



Pjesë e programit ishte trajtimi i temave kryesore që lidhen me transpozimin e direktivës së fundit të BE-së për sigurimin motorik në ligjin shqiptar të sigurimeve, sistemin e tarifave dhe përcaktimin e proceduarave për zgjidhjen e dëmeve sipas standardeve të BE-së. Në ditën e dytë të trajnimit

u prezantuan edhe eksperiencat e vendeve të ndryshme të Evropës lidhur me vendosjen e një sistemi kompensimi për aksidentet që përfshijnë mjetet e paregjistruara apo të pidentifikuara. Pjesëmarrësit, gjatë dy ditëve të trajnimit, u njohën me bazën teorike të legjislacionit dhe e konkretizuan atë me raste studimore të vendeve të ndryshme evropiane.

Ekspertë në këtë mision ishin Z. Massimo Paturzo dhe Znj. Patrizia Di Benedetto, nga Autoriteti Mbikëqyrës i Italisë, IVASS (Istituto Vigilanza Sulle Assicurazioni) me eksperiencë të gjerë në tregun italian të sigurimeve. AMF, me mbështetjen e Bashkimit Evropian nëpërmjet instrumentit TAIEX, do të realizojë gjatë vitit 2013 edhe katër misione të tjera ekspertize dhe trajnimi me tematika të ndryshme për forcimin e kapaciteteve të saj rregullatore për tregjet nën mbikëqyrje.

## **Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në takime pune me drejtues të Bankës Kombëtare të Çekisë lidhur me pensionet private vullnetare**

**14-15 mars**

Znj. Enkeleda Shehi, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe anëtar i Bordit të AMF-së Z. Astrit Hado së bashku me një grup nga AMF zhvilluan në datat 14-15 mars takime me drejtues të departamenteve të ndryshme të Bankës Kombëtare të Çekisë dhe fondeve të pensioneve private. Programi u realizua me mbështetjen e Bankës Botërore, në kuadër të projektit për shkëmbimin e përvojave në fushën e pensioneve private vullnetare.

Tematikat kryesore të diskutimeve lidheshin me ndërtimin e një reforme në sistemin e pensioneve duke e përshtatur atë me rregullat e Bashkimit Evropian. Shkëmbimi i përvojave u lidh edhe me strategjitë teknike të sistemit të pensioneve private vullnetare si licencimi, praktikat e mbikëqyrjes për kolonën e dytë dhe të tretë të pensioneve, fuqitë rregullatore, etj.

Një vëmendje e veçantë ju kushtua edhe mbrojtjes konsumatore në këtë fushë duke e ndërthurur atë me përkufizimin e eksperiencave në Republikën Çeke lidhur me planet personale të pensioneve, llogaritë personale dhe menaxhimin e tyre, tipologjitë e skemave të pensionit, asetet dhe limitet në investimin e tyre, etj.

Në ditën e dytë të vizitës, grupi nga AMF vizitoi edhe fondin privat të pensionit "ING Penzijni" duke u njohur konkretisht me menaxhimin dhe eksperiencën e tyre në tregun çek të pensioneve private.

Tematikat kryesore të diskutimeve lidheshin me ndërtimin e një reforme në sistemin e pensioneve duke e përshtatur atë me rregullat e Bashkimit Evropian. Shkëmbimi i përvojave u lidh edhe me strategjitë teknike të sistemit të pensioneve private vullnetare si licencimi, praktikat e mbikëqyrjes për kolonën e dytë dhe të tretë të pensioneve, fuqitë rregullatore, etj.

Në Nënkomitetin e Edukimit, pjesëmarrësit diskutuan mbi kurikulumin bazë të trajnimeve si edhe mundësinë e përditësimit të saj me iniciativat e ardhura nga grupet e punës.

## Takime të Nënkomiteteve të IAIS, Bazel, Zvicër

19-22 mars

Z. Mati Pepa, nënkryetar i AMF-së mori pjesë në mbledhjet e Nënkomiteteve të IAIS (*International Association of Insurance Supervisors*) e cila u zhvillua në datat 19-22 mars në Bazel, Zvicër. IAIS drejtohet nga një Komiteti Ekzekutiv, anëtarët e të cilit përfaqësojnë rajone të ndryshme gjeografike. Ai mbështetet nga Komiteti Teknik, Komiteti i Zbatimit, Komisioni për Buxhet dhe Komiteti i Stabilitetit Financiar. Mbledhjet e këtyre komiteteve janë të përvitshme dhe organizohen me synim rithexsimin e principeve, standardeve si edhe për të dhënë mbështetje për çështje të lidhura me mbikëqyrjen në sigurime.



Në Nënkomitetin e Edukimit, pjesëmarrësit diskutuan mbi kurikulumin bazë të trajnimeve si edhe mundësinë e përditësimit të saj me iniciativat e ardhura nga grupet e punës. Gjithashtu u diskutuan edhe planet për periudhën 2014-2015. Takimi i datës 20 mars u fokusua në tregjet e reja të vendeve në zhvillim.

E themeluar që në vitin 1993, Shoqata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS) përfaqëson rregullatorët dhe mbikëqyrësit e sigurimeve nga më shumë se 200 juridiksione. IAIS punon ngushtë me organet e tjera të sektorit financiar në vendosjen e standardeve dhe organizatat ndërkombëtare për të promovuar stabilitetin financiar. AMF është anëtare e IAIS që prej vitit 2001.

## LAJMET NGA RAJONI

### Bosnje-Hercegovinë

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në fund të vitin 2012, dëmet e paguara nga siguruesit e Bosnje-Hercegovinës për sigurimin TPL arritën në një total prej 44.73 milion euro, nga të cilat rreth 29% ishin për dëme jo-materiale. Në të njëjtën periudhë, Fondi Mbrojtës pagoi rreth 900 mijë euro për dëmet jo-materiale.



Tregu TPL-së në Bosnje-Hercegovinë ende nuk është i liberalizuar, por Banka Botërore ka iniciuar një projekt në lidhje me liberalizimin e këtij tregu. Efektet e kësaj nisme do të fillojnë të jenë të dukshme në treg gjatë muajve të ardhshëm.



## Kroaci

www.xprimm.com

Aktualisht, në tregun kroat të sigurimeve, vlerësimi dhe niveli i kompensimit për dëmtimet trupore (fizike) vendoset nga gjykatat, të cilat përdorin kriteret e vendosura nga Gjykata e Lartë e vendit. Por kjo procedurë pritet të ndryshojë me projekt ligjin e ri të propozuar nga Ministria e Financave i cili parashikon tabela mjekësore dhe tabela të dëmshpërblimeve për t'u zbatuar në sistemin e vlerësimit dhe kompensimit të dëmeve lidhur me dëmtimet personale (fizike).



—  
Duke filluar nga viti 2017, normat e TPL-së në tregun e sigurimeve në Mal të Zi do të liberalizohen.  
—

## Mali i Zi

www.xprimm.com

Duke filluar nga viti 2017, normat e TPL-së në tregun e sigurimeve në Mal të Zi do të liberalizohen. Kjo është përcaktuar në bazë të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm në Trafik (*Law on Compulsory Insurance in Traffic-Official Gazette No. 44/12*) i cili përcakton një periudhë tranzitore prej pesë vjetësh për liberalizimin e çmimeve.



“Pas kësaj periudhe pesë vjeçare, kompanitë e sigurimeve duhet të përcaktojnë vetë tarifatat e tyre individuale”, u shpreh Boris Saban, Drejtor Ekzekutiv, i Byrosë Kombëtare të Siguruesve të Malit të Zi.

Sipas Borin Saban, Shoqata e Sigurimeve Malazeze (Montenegrin Insurance Association) do të miratojë së shpejti tarifatat e përbashkëta minimale për TPL-në, sipas kufijve të rinj të përgjegjësive që do të jenë në përdorim për pesë vitet e para. “Zbatimi i primit minimal të TPL-së do të monitorohet rregullisht nga autoriteti mbikëqyrës”, tha Borin Saban.

Kufijtë minimale të përgjegjësive do të rriten nga 150,000 euro që është tani në 550,000 euro në gusht 2015 për dëmtimet personale (fizike). Ndërsa për dëmet materiale kufijtë do të rritet nga 80,000 euro në 300,000 euro.

### Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, T. Cani, L. Rama, J. Kurti, A. Çeku, R. Eltari,  
E. Beqir-Aga, Dh. Hazbiu, E. Kokona.